




**ANALIZA E RASTEVE
FEMICIDE
VRASJE TË GRAVE NË
REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT**

2017 – 2020



ANALIZA E RASTEVE FEMICIDE

VRASJE TË GRAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

2017-2020

Shkup, shtator 2021

Ky publikim është punuar me përkrahjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Federative të Gjermanisë, në kuadër të projektit "Përmirësimi i praktikave kombëtare në lidhje me armët e vogla dhe të lehta dhe ndërtimin e komuniteteve të rezistueshme ndaj dhunës". (Improving National SALW-related Practices and Building Violence Resilient Communities). Projekti realizohet nga zyra e UNDP-së në Shkup në kuadër të "Udhëzuesit për zgjidhje të qëndrueshme të posedimit ilegal, keqpërdorimit dhe tregtisë me armë të vogla dhe të lehta dhe municionit, në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024".

Autori i publikimit

Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës në familje "Zëri kundër dhunës".

Autore: Elena Dimushevska

Hulumtuese: Frosina Ivanovska, Antigona Alili.

Përmbajtja e publikimit dhe qëndrimet e tij janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Federative të Gjermanisë.

Copyright © 2021

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Jordan Hadzi Konstantinov - Dzinot 23 1000, Shkup

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose të transmetohet, në çfarëdo forme në mënyre elektronike, mekanike, fotokopje apo ndryshe, pa lejen paraprake të UNDP-së.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	4
2. Përkufizimi i femicideve	6
3. Legjislacioni kombëtar	11
4. Metodologjia	14
5. Konstatimet	16
6. Konstatimet nga shqyrtimet e realizuara të lëndëve gjyqësore	18
7. Femicidet dhe armët e zjarrit	22
8. Prezantimi mediatik i rasteve femicide	23
9. Konkluzionet	26
10. Rekomandimet	28
11. Bibliografia	29

HYRJE

Femicidet, respektivisht vrasja e grave dhe vajzave është një prej arsyeve kryesore për vdekjen e hershme të grave në nivel global dhe përbëjnë formën më ekstreme të dhunës ndaj grave. Femicidet janë një problem global që njihet edhe nga komuniteti ndërkombëtar që para 25 vitesh. Sipas studimit të publikuar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për drogat dhe kriminalitetin (UNDOC), në vitin 2017, gjithsej janë vrarë 87.000 gra. Me tepër se gjysma e tyre (50.000 gra ose 58%) janë vrarë nga partneri intim ose anëtar tjetër i familjes, nga ku dalin të dhënat se çdo ditë 137 gra janë vrarë nga ndonjë i afërm, nga dikush që i kanë besuar¹. I njëjti studim tregon se në vitin 2012 numri i grave të vrara nga partneri intim në nivel global ka qenë 48.000 (47% nga numri i përgjithshëm i grave të vrara). Së këndejmë mund të vijmë në përfundim se numri i femicideve - vrasjeve të grave ka tendencë rritjeje përgjatë viteve. Sipas të dhënave të këtij studimi, Afrika është rajoni ku gratë janë në rrezik më të madh për t'u vrarë (3.1 në 100.000 të popullatës femërore), ndërsa Evropa është rajoni ku rreziku është më i vogël (0,7 në 100.000 të popullatës femërore).

Si formë më ekstreme e dhunës, femicidet përbëjnë kërcënim për sigurinë e grave në tërë botën. Edhe pse paraqiten në kontekste të ndryshme, si pasojë e dhunës intime nga partneri ose dhunës familjare, dhunës seksuale, në konflikt të armatosur, ose me qëllim të a.sh. ruajtjen e nderit të familjes ("vrasje në emër të nderit"), megjithatë arsyet kryesore gjenden në ndarjen e pabarabartë të fuqisë ndërmjet grave dhe burrave, dhe vlerave patriarkale të ngulitura thellë, madje edhe në vendet më të zhvilluara.

Kjo analizë është realizuar me përkrahjen e projektit të qeverisë gjermane "Përmirësimi i praktikave kombëtare në lidhje me armët e vogla dhe të lehta dhe ndërtimi i komuniteteve të rezistueshme ndaj dhunës" që realizohet nga UNDP. Projekti është pjesë e një iniciative më të gjerë rajonale, Udhëzues për zgjidhje të qëndrueshme për posedim ilegal, keqpërdorim dhe tregti ilegale të armëve të vogla dhe të lehta dhe municionit në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024. Përmes përmirësimit të grumbullimit të të dhënave, analizës dhe shpërndarjes së informatave në lidhje me armët e vogla dhe lehta, sigurohet që politikat dhe praktikat për kontrollin e tyre të udhëhiqen nga analizat dhe të bazuar në fakte. Aspekti gjinor i projektit ka rëndësi të veçantë që këto politika dhe praktika të kenë rezultate më të mira për ndërtimin e një shoqërie të rezistueshme ndaj dhunës.

Pandemia botërore shëndetësore me COVID 19 e ka rritur rrezikun e dhunës me bazë gjinore. Gjatë tre muajve të parë të fillimit të pandemisë, shumë vende Evropiane si dhe vende të Ballkanit Perëndimor kanë publikuar statistika për rritjen e numrit të denoncimeve për dhunë familjare prej madje 30-40%. Sistemet për mbrojtjen e grave viktime u riorganizuan me qëllim për të siguruar ndihmë dhe përkrahje urgjente për viktimat. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut është shënuar rritje e denoncimeve të dhunës familjare, veçanërisht pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme dhe uljes së masave për ndalimin e lëvizjes.

Ajo që ka rëndësi është fakti që ka rritje prej 25% të numrit të ankesave për dhunë familjare në vitin 2020, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe ditëve të karantinës.

Në nivel vjetor, krahasuar me vitin 2019 shënohet rritje prej 18% për ankesa të dhunës familjare. Sipas të dhënave të MPB-së në vitin 2020 nuk ka pasur rritje të konsiderueshme të numrit të veprave penale në lidhje me dhunën familjare, krahasuar me vitin 2019. Sipas statistikës zyrtare të MPB-së, numri i veprave penale në vitin 2019 ka qenë 989², ndërsa në vitin 2020 ka qenë 992³. Ende mbetet përqindja e lartë e grave viktime të veprave penale të dhunës familjare prej 81%, respektivisht 85%.

Organizatrat civile të grave/vajzave që udhëheqin me shërbimet e specializuara për gratë që janë viktime të dhunës, kanë njoftuar për rritjen e numrit të thirrjeve në linjat S.O.S dhe shërbimet e ndihmës juridike falas edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Organizatat apelojnë edhe për riorganizimin urgjent të punës së Qendrave për Punë Sociale dhe adaptimit të tyre ndaj situatës së re.

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e Maqedonisë së Veriut, në mars 2020, nënkuptoi edhe miratimin e masave urgjente (shëndetësore, sociale dhe ekonomike) për ndihmë në tejkalimin e pasojave të krizës shëndetësore. Por, mbrojtja e viktimeve të dhunës familjare, veçanërisht grave dhe fëmijëve që janë në rrezik më të madh, në tërësi ishte lënë anash si një aspekt që duhet të jetë pjesë e masave urgjente. Rrjeti kombëtar

¹ Global study on homicide: Gender related killing of women and girls, 2019 që është në [linkun](#)

² Raport final 2020, Ministria e Punëve të Brendshme, [link](#)

³ Përgjigja e Kërkesës për informata me karakter publik, 09.02.2021, Ministria e Punëve të Brendshme

kundër dhunës ndaj femrave, në fillim të muajit prill 2020 i dërgoi dy kërkesa Qeverisë së RMV-së: Kërkesë për plotësimin e vendimit për ndalimin e lëvizjes së qytetarëve në tërë territorin e shtetit⁴ dhe Kërkesë për shqiptimin e masave urgjente për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve viktime të dhunës familjare, deri sa zgjatë kjo gjendje e jashtëzakonshme⁵.

Përgjigja e institucioneve ndaj kërkesave të parashtruara dhe hapave të ndërmarrë nga ana e tyre për adaptimin e sistemit të mbrojtjes së situatës së sapo shkaktuar është prezantuar në dokumentin e përgatitur nga Rrejtji - Shqyrtimi i masave dhe hapave urgjente të ndërmarrë për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve viktime të dhunës në familje, nga Qeveria dhe institucionet kompetente⁶.

Në periudhën Prill-Maj 2020, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe ndalimqarkullimit ndodhën dy femicide në Shkup⁷, që vetëm tregoi faktin për nevojë urgjente të mobilizimit dhe riorganizimit të institucioneve me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së viktimeve në kohë pandemie. Fatkeqësisht, siç tregoi edhe dokumenti i lartpërmendur, institucionet nuk konsideronin se kjo çështje duhet të ketë prioritet dhe nuk ndërmorrën hapa të rëndësishëm për avancimin e mbrojtjes së grave, viktime të dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore.

Dhuna e bazuar në gjini dhe femicidet si formë më e rëndë, sikurse edhe virusi COVID 19, mund të paraqiten në të gjitha shtresat e shoqërisë, nuk diskriminojnë dhe nuk zgjedhin moshë, nacionalitet dhe pozitë socio-ekonomike. Siç e quajnë edhe shumë ekspert, në mesin e të cilëve edhe Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, si pandemi e "fshehur" ku si pasojë mijëra gra dhe vajza i humbin jetët e tyre nga ana e personave të cilëve ju besojnë.

Qëllimi i kësaj analize është që ta tregojë gjendjen me vrasjet e grave dhe vajzave në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën nga viti 2017 e deri në vitin 2020, e që është vazhdimësi e Analizës së parë të rasteve femicide - vrasje të grave në Republikën e Maqedonisë⁸, e realizuar nga Rrejtji Kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, me përkrahje teknike dhe financiare nga Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Konstatimet e fituara nga analiza do të shfrytëzohen për zhvillimin e rekomandimeve për avancimin e sistemit për parandalimin dhe mbrojtjen e grave viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, që do të kontribuojë për parandalimin e rasteve femicide si pasojë e ekspozimit shumëvjeçar ndaj dhunës nga partneri intim dhe dhunës në familje.

4 Kërkesë për plotësimin e vendimit për ndalimin e lëvizjes së qytetarëve në tërë territorin e shtetit që mund të merret në [link](#)

5 Kërkesë për shqiptimin e masave urgjente për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve viktime të dhunës në familje, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, që mund të merret [link](#)

6 Shqyrtimi i masave dhe hapave urgjent, të ndërmarrë për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve viktime gjatë dhunës në familje nga Qeveria dhe institucionet kompetente, merret në [linku](#)

7 Dy femicide në më pak se dy javë, janë shenjë se sistemi nuk funksionon për ballafaqimin me dhunën në familje dhe dhunën në bazë gjinore, merret në [linku](#)

8 Analiza e femicideve - vrasjeve të grave në Republikën e Maqedonisë, 2018 merret në [linku](#)

DEFINIMI I FEMICIDEVE

Si themelues i konceptit për femicide konsiderohet feministja amerikane Dijana H. Rasel e cila në vitin 1976, në Gjykatën e parë ndërkombëtare për krime kundër grave kishte deklaruar: "E përzgjedha termin e ri femicid për t'i shënuar vrasjet e grave nga ana e burrave, vetëm se janë gra". Megjithëse fjala femicid veç më ishte e njohur për gjuhën anglosaksone, por duke e përdorur atë, Raseli i dha kuptim politik dhe e ka vendosur në kornizën më të gjerë politike feministe. Me vonë, Raseli e ripërkufizon konceptin e femicideve si "vrasje mizogjene e grave" nga ana e burrave dhe manifestimi ekstrem i dhunës familjare - një shtojcë e propozuar nga Liz Keli, që e potencon natyrën gjinore të dhunës ndaj grave dhe fokusohet në dëshirën mashkullore për fuqi, dominim dhe kontroll⁹.

Kombet e Bashkuara e definojnë femicidin/femicidin si "vrasje e grave me bazë gjinore" që mund të ketë shumë forma, si: vrasje intime-partneri, vrasje të grave të akuzuara për shtrigëri/magji, vrasje të grave në "emër të nderit", vrasje të grave në konflikte të armatosura, vrasje të grave për shkak të prikës, vrasje si rezultat i orientimit seksual ose identitetit gjinor, etj.

Deklarata e Vjenës për femicidet¹⁰ i definojnë si "vrasje të grave për shkak të gjinisë së tyre", e që mund të kenë formë të: 1) vrasjes si rezultat i dhunës në familje/partnerit intim; 2) torturës dhe vrasjes mizogjene të grave; 3) vrasja e grave në "emër të nderit"; 4) vrasjes e targetuar e grave gjatë konflikteve të armatosura; 5) vrasjas e grave për shkak të prikës; 6) vrasja e grave për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor; 7) vrasja e Aborixhinëve dhe grave autoktone dhe vajzave të tyre për shkak të gjinisë së tyre; 8) infanticidit dhe feticitit femëror (përzgjedhja gjinore bazuar në seksin); 9) vdekja si rezultat i sakatimit gjenital femëror; 10) vrasjes për shkak të akuzës për shtrigëri; 11) lloje tjera të femicideve që kanë lidhje me bandat, krimin e organizuar, drogën, tregtinë me njerëz dhe posedimit të armëve.

Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), duke marrë parasysh përvojat e vendeve evropiane, u mundua që të zhvillojë dy përkufizime për femicidin: një të përgjithshme që del nga Deklarata e Vjenës që përmendet paraprakisht dhe ajo statistikore që i kufizon femicidet si vrasje intime nga partnerët dhe vrasje të grave si rezultat i praktikave të dëmshme.

Përkufizimi i përgjithshëm është si vijon:

„Termi femicid shënon vrasjet e grave dhe vajzave për shkak të gjinisë së tyre, të kryera dhe toleruara nga aktorë privatë dhe publikë. Përfshin vrasjet e grave si pasojë e dhunës nga partneri intim, torturës dhe vrasjet mizogjene të grave, vrasjet e grave dhe vajzave në "emër të nderit" dhe vrasjet si pasojë e praktikave tjera të dëmshme, vrasjet e targetuara të grave dhe vajzave gjatë konflikteve të armatosura dhe rastet femicide që kanë lidhje me bandat, krimin e organizuar, shitësit e drogës dhe trafikimin me gra dhe vajza.“

Përkufizimi statistikor është si vijon:

„Vrasjet e grave nga ana e partnerit intim dhe vdekja e grave si pasojë e praktikave të dëmshme për gratë. Partneri intim nënkupton ish-bashkëshort ose partner i mëparshëm ose i tanishëm, pa marrë parasysh nëse autori i krimit ka jetuar në të njëjtin vendbanim me viktimën“¹¹.

Instituti Evropian për Barazi Gjinore, gjithashtu ka analizuar rregullimin ligjor të femicideve në vendet anëtare të Bashkimit Evropian¹². Mosekzistimi i një përkufizimi të posaçëm për femicidin në asnjë vend evropian, ka nxitur autorët e këtij dokumenti që t'i analizojnë definicionet e veprës themelore të vrasjes me fokus të posaçëm kur vepra është kryer në kontekst të dhunës intime nga partneri, duke marrë parasysh elementet e ndryshme të veprës, siç janë: vrasje e qëllimshme, vrasje e bazuar në gjininë e gruas nga ana e burrit, vrasje nga partneri i mëparshëm/tanishëm, vdekja e gruas si rezultat i dhunës nga partneri intim, dhunës si pasojë e sakatimit gjenital të femrës dhe vdekja si pasojë e abortit të pasigurt.

⁹ Femicide across Europe që mund të merret në [link](#)

¹⁰ Statement submitted by the Academic Council on the United Nations System, a non-governmental organization in consultative status with the Economic and Social Council që mund të merret në [link](#)

¹¹ [femicide | European Institute for Gender Equality \(europa.eu\)](#)

¹² [Terminology and indicators for data collection: Rape, femicide and intimate partner violence - Report | EIGE \(europa.eu\)](#)

Në tabelën nr. 1 janë prezantuar komponentët e femicidit, të rregulluara në legjislacionin e vendeve anëtare të BE-së. Me një yll (*) janë shënuar vendet të cilat e kanë paraparë këtë komponent specifik si rrethanë vështirësuese.

	Vende anëtare të Bashkimit Evropian	
Vrasje me paramendim	PO: Belgjika, Bullgaria, Çekia, Gjermania, Estonia, Irlanda, Greqia, Spanja, Franca, Kroacia, Italia, Qipro, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Hungaria, Holanda, Austria, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Suedia, Anglia	24
	JO: Danimarka, Malta, Sllovenia, Finlanda	4
Vrasje e grave në bazë gjinore	PO: (Belgjika, Estonia, Greqia, Spanja, Portugalia, Sllovenia)	6
	JO:(Bullgaria, Çekia, Danimarka, Gjermania, Irlanda, Franca, Kroacia, Italia, Qipro, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Hungaria, Malta, Holanda, Austria, Polonia, Rumania, Sllovakia, Finlanda, Suedia, Anglia).	22
Vrasje e partnerit/ bashkëshortit	PO: (Danimarka, Estonia, Franca, Letonia, Lituania, Portugalia, Rumania)	7
	JO: (Belgjika, Çekia, Danimarka, Gjermania, Irlanda, Franca, Kroacia, Italia, Qipro, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Hungaria, Malta, Holanda, Austria, Polonia, Sllovenia, Sllovakia, Finlanda, Suedia, Anglia)	21
Vrasja e grave si rezultat i dhunës intime të partnerit	PO: (Danimarka, Spanja, Franca, Letonia, Lituania, Portugalia, Rumania)	5
	JO: (Belgjika, Bullgaria, Çekia, Danimarka, Gjermania, Irlanda, Greqia, Franca, Qipro, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Hungaria, Malta, Holanda, Portugalia, Polonia, Rumania, Sllovenia, Suedia, Finlanda, Suedia, Anglia).	23
Vdekje si rezultat i sakatimit gjeneral të grave	Vepër e veçantë penale: (Belgjika, Danimarka, Franca, Italia, Qipro, Luksemburgu, Holanda, Polonia, Sllovakia)	9
Vdekje si rezultat i abortit të pasigurt	Vepër e veçantë penale: (Belgjika, Gjermania, Greqia, Kroacia, Qipro, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Hungaria, Austria, Rumania, Sllovenia, Suedia, Suedia)	14
Vrasje për shkak të prikës	Asnjë prej 28 anëtareve nuk e thekson se shënohet si vrasje, por i identifikon me masa konkrete si rrethana vështirësuese	0
Vrasje në emër të nderit	Asnjë prej 28 anëtareve nuk e thekson se shënohet si vrasje, por i identifikon me masa konkrete si rrethana vështirësuese	0
Feticidi femëror	Asnjë prej 28 anëtareve nuk e ka këtë komponent. (Vrasja e fëmijës së vet është një shkelje e veçantë në disa vende-anëtare)	0

Në këtë mënyrë janë analizuar edhe përkufizimet për vrasjet, që janë miratuar nga organizatat ndërkombëtare (Parlamenti Evropian, Eurostat, Këshilli i Evropës, Deklarata e Vjenës për femicide, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Raportuesja e posaçme e Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave, Komisari i lartë i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut). Konstatimet nga këto përkufizime janë prezantuar në tabelën 2.

Tabela 2: Elementet evropiane dhe ndërkombëtare të përdorura më së shpeshti për përkufizimin e femicidit

	Vrasje me paramendim	Vrasje në bazë gjinore	Konteksti i dhunës së vazhdueshme	Pozita nënshtruese, marginalizimi dhe rreziku	Vrasja e grave nga partnerët e mëparshëm intim ose si rezultat i dhunës intime nga partneri	Vrasja e grave ku përfshihet edhe dhuna seksuale	Vrasje në emër të nderit	Vrasje si pasojë e sakatimit gjeneral të gruas	Infanticidi femëror	Vdekje si pasojë e abortit të pasigurt	Vdekje si pasojë e abortit të pasigurt
Parlamenti Evropian	✓	✓									
Libri Evropian i statistikës së krimit dhe drejtësisë penale HEUNI	✓										
Eurostat	✓										
Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës	✓	✓	✓	✓	✓						
Deklarata e Vjenës për femicide (Kombet e Bashkuara)	✓	✓			✓		✓	✓	✓		✓
Organizata Botërore e Shëndetësisë	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓				✓
Raportuesja speciale për dhunën ndaj grave - Kombet e Bashkuara	✓	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓	✓	✓
Komisari i Lartë për të Drejtat e Njeriut - Kombet e Bashkuara	✓	✓			✓	✓		✓			
Klasifikimi i veprave penale për qëllime statistikore	✓										

Në nivel ndërkombëtar nuk ekziston një përkufizim i pranuar në përgjithësi për femicid, andaj si pikënisje shfrytëzohet përkufizimi themelor i vrasjes. Me këtë rast merren parasysh elementet që secili vend i shfrytëzon për përkufizim më specifik të vrasjes me bazë gjinore. Nga ligjet e vendeve të ndryshme, këto elemente janë si rrethana vështirësuese gjatë kualifikimit të veprës megjithëse konstatimet nga hulumtimi i Institutit Evropian për Barazi Gjinore tregojnë se është i vogël numri i vendeve anëtare që në fakt i marrin parasysh këto rrethana vështirësuese. "Dhuna e qëllimshme" është element i përkufizimit të vrasjes në 24 vende anëtare të BE-së; "vrasja e me bazë gjinore e një gruaje nga ana e një burri" është rrethanë vështirësuese në 6 (gjashtë) vende anëtare; "vrasja e ish-partnerit/partnerit aktual" është përfshirë si rrethanë vështirësuese në 7 (shtatë) vende anëtare "vdekja e grave si rezultat i dhunës nga partneri intim" ekziston si rrethanë vështirësuese në 5 (pesë) vende anëtare, ndërsa vdekja si pasojë e sakatimit gjeneral nuk hyn në përkufizimin për vrasje në asnjë vend anëtar, respektivisht vetëm 9 (nëntë) vende anëtare e njohin atë si vepër e veçantë penale. I ngjashëm është edhe konstatimi për "vdekjen si pasojë e

abortit të pasigurt” që është vepër e veçantë penale në 14 (katërmbëdhjetë) vende anëtare.

Mosekzistimi i përkufizimit të unifikuar të femicidit e vështirëson grumbullimin e të dhënave statistikore për këtë formë më ekstreme të dhunës me bazë gjinore. Si problem plotësues paraqitet edhe mosekzistimi i një sistemi të unifikuar për grumbullimin e të dhënave në nivel nacional dhe ndërkombëtar.

Sipas hulumtimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNDOC) të publikuar në vitin 2019 (që është hulumtimi i vetëm që siguron statistikë për numrin e vrasjeve të grave në nivel global), gjashtë në dhjetë gra në botë (58%) janë të vrara qëllimisht nga partneri intim ose nga anëtar tjetër i familjes. Më konkretisht, nga numri i përgjithshëm i vrasjeve të grave, 34% janë kryer nga partneri intim, 24% nga anëtar i familjes, ndërsa 42% të tjera nga autori jashtë familjes. Vlen të përmendet se nuk ekziston një ndarje e barabartë e përqindjes së vrasjeve sipas rajoneve të ndryshme të botës. Së këndejmi, Afrika ka shkallën më të lartë - 68% nga numri i përgjithshëm i vrasjeve të grave ku autori i vrasjes është partneri intim ose anëtar i familjes, ndërsa në Evropë kjo përqindje është 38¹³.


I njëjti hulumtim na jep informatë se një në pesë vrasje në nivel global është kryer nga partneri intim ose anëtar tjetër i familjes, si dhe se gratë janë më së shpeshti viktimat të këtij lloji të vrasjes - 36% e viktimave janë burra, ndërsa 64% janë gra, duke e konfirmuar faktin se shtëpia është vendi më i pasigurt për gratë dhe se ato janë më së shpeshti të vrara nga njeri i afërm të cilit i besojnë.

Gjendja me vrasjet e grave dhe femicidet në vende të caktuara të Evropës është paraqitur në Tabelën 3. Me ngjyrë të zezë është shënuar numri i përgjithshëm i grave të vrara ndërsa me ngjyrë vjollcë janë shënuar vrasjet e femrave që janë kryer nga partneri intim ose nga anëtar i familjes - femicidë.

Tabela 3: Shkalla e vrasjeve të grave dhe femicidëve në 100.000 popullatë femërore në vende të caktuara të Evropës, për vitin 2016.

Numri i përgjithshëm i vrasjeve të grave dhe vrasjet që lidhen me partnerin intim/familjen në shtetet e përzgjedhura

Shkalla e numrit të përgjithshëm të vrasjeve të grave dhe vrasjet që lidhen me partnerin intim/familjen, shtetet e përzgjedhura në Evropë, 2016



Burimi: Statistikat e UNODC për vrasjet


13 Global study on homicide: Gender related killing of women and girls, 2019 që mund të merret në [link](#)

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në periudhën nga viti 2008 e deri në vitin 2020 janë vrarë gjithsej 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) gra, prej të cilave së paku 50 janë femicide.

Shkalla e vrasjeve të grave dhe femicideve në periudhën e përfshirë me këtë analizë është paraqitur në tabelën në vijim. Përqindja e femicideve në 100.000 popullsi femërore është paraqitur në tabelën 3.

Tabela 3: Shkalla e vrasjeve të grave dhe femicideve në Maqedoninë e Veriut për periudhën 2017-2020

Shkalla në 100.000 popullsi femërore



LEGJISLACIONI KOMBËTAR

Legjislacioni maqedonas nuk e njeh nocionin femicid, andaj si rrjedhojë nuk e rregullon si vepër të veçantë penale. Ajo që është pjesë e kodit penal është vrasja themelore (neni 123), ndërsa kryerja e veprës penale Vrasje gjatë dhunës në familje është paraparë si rrethanë vështirësuese në të njëjtin nen, në paragrafin 2, pika 2. Me përfshirjen e dhunës në familje si rrethanë vështirësuese parashihet dënim më i rëndë për autorin, respektivisht me minimum prej 10 viteve deri në burgim të përjetshëm. Krahas privimit nga jeta gjatë dhunës në familje (pika 2), në nenin 123 të Kodit Penal¹⁴ janë përkufizuar edhe këto rrethana vështirësuese:

1. tjetrin do ta privojë nga jeta në mënyrë mizore dhe tinëzare;
2. tjetrin do ta privojë nga jeta dhe gjithashtu me paramendim do ta vë në rrezik jetën edhe të ndonjë personi tjetër;
3. tjetrin do ta privojë nga jeta për shkak të interesit, për shkak të kryerjes ose mbulimit të ndonjë vepre tjetër penale, për shkak të hakmarrjes së pamëshirshme, nga urrejtja ose për shkak të motiveve tjera të ulëta;
4. tjetrin do ta privojë nga jeta me porosi;
5. do të privojë nga jeta grua për të cilën e di se është shtatzënë ose person i mitur dhe
6. do të privojë nga jeta gjykatës, prokuror publik ose avokat, gjatë kryerjes së funksionit të vet, përkatësisht veprimtarisë ose person zyrtar ose ushtarak gjatë kryerjes së punëve të sigurisë publike ose shtetërore ose të detyrës ruajtje të rendit publik, kapjen e autorit të veprës penale ose ruajtje të personit të privuar nga liria.

Republika e Maqedonisë së Veriut e ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave, përfshirë edhe dhunën në familje (e njohur edhe si Konventa e Stambollit) në dhjetor të vitit 2017, e që hyri në fuqi në korrik të vitit 2018. Në drejtim të implementimit më efikas të Konventës së Stambollit, përmes harmonizimit të legjislacionit kombëtar me dispozitat e këtij dokumenti, u zhvillua dhe miratua nga Qeveria e RMV-së, në tetor të vitit 2018 edhe Plan veprimi kombëtar 2018-2023 (PNV).

PVK-ja i përfshin të gjitha institucionet relevante dhe i parasheh të gjitha ndryshimet që duhet të bëhen në tri sferat e identifikuara: legjislativ, parandalim dhe mbrojtje.

Kodi Penal është një prej ligjeve themelore që duhet të harmonizohen me dispozitat e Konventës së Stambollit, respektivisht të bëhen ndryshime dhe plotësime për kriminalizimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore. Sipas "Raportit për progresin e RMV-së të zbatimit të Plan veprimi kombëtar për Konventën e Stambollit" në periudhë prej dy vitesh (tetor 2018-tetor 2020)¹⁵, "është formuar një grup pune në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në të cilën nuk janë ftuar organizatat civile megjithëse bashkëpunimi me ta është paraparë në PVK" për implementimin e KS. Para formimit të këtij grupi në periudhën paraprake, Kodi Penal u shqyrtua dhe u plotësua nga një grup pune i mbyllur, i formuar nga ASHAM dhe OSBE".

Në periudhën e përgatitjes së kësaj analize, u shpalesh edhe propozim teksti i Kodit Penal, i përgatitur nga grupi i punës me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet me të cilat është paraparë përkufizimi i dhunës me bazë gjinore, në fjalorthin e ligjit, harmonizimi i elementeve të veprës penale përdhunim me dispozitat e Konventës, si dhe kriminalizimi i përgjimit, shqetësimit seksual, dhunës psikologjike, sakatimit gjenital dhe dënimit më të rreptë të veprave penale që janë kryer për të ruajtur nderin. Në raport me vrasjen e grave, femicidi nuk është pranuar si vepër e veçantë penale, por ekziston rrethanë vështirësuese nëse vepra është kryer gjatë dhunës me bazë gjinore ose dhunës në familje.

Propozim-teksti është miratuar nga Qeveria e RMV-së më 28 korrik të vitit 2021 dhe ka hyrë në procedurë parlamentare që jep hapësirë për t'u bërë ndryshime dhe plotësime shtesë.

Me vetë ratifikimin e Konventës së Stambollit, shteti i ka pranuar dispozitat e rregulluara me këtë dokument dhe është zotuar që të respektohen ato.

Pavarësisht faktit se a do të bëhen ndryshimet dhe plotësimet e legjislacionit kombëtar, dispozitat e Konventës së Stambollit mund të shfrytëzohen në praktikat gjyqësore me përjashtim të neneve ku shteti ka rezerva, në pajtim

¹⁴ Kodi Penal mund të merret në [link](#)

¹⁵ Raporti i përparimit të R. Maqedonisë së Veriut gjatë realizimit të Planit Nacional të Veprimit për implementimin e Konventës së Stambollit, që mund të merret në [link](#)

me nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë¹⁶.

Duke marrë parasysh faktin se Konventa e Stambollit i njeh format e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe vrasjen e grave si dhunë fizike që mund të rezultojë me vdekje, jep rekomandime për përndjekjen penale të autorëve dhe i parasheh rrethanat vështirësuese gjatë përcaktimit të sanksionit dhe sistemi gjyqësor maqedonas duhet t'i shfrytëzojë në praktikë dispozitat në fjalë.

Rrethanat vështirësuese sipas Konventës së Stambollit janë:

- a. vepra penale e kryer ndaj bashkëshortit respektivisht ish-partnerit ose partnerit të tanishëm, në pajtim me legjislacionin kombëtar, nga ana e një anëtarit të familjes, personi që jeton së bashku me viktimën ose personi që ka keqpërdorur autoritetin e vet;
- b. vepra penale, respektivisht veprat e ngjashme janë përsëritur;
- v. vepra penale është kryer ndaj një personi të rrezikuar në rrethana të caktuara;
- g. vepra penale është kryer ndaj ose në prani të një fëmije;
- d. vepra penale është kryer nga dy ose më tepër persona që kanë vepruar bashkërisht;
- gj. veprës penale i ka paraprirë ose është kryer me nivel ekstrem të dhunës;
- e. vepra penale është kryer me përdorimin ose kërcënim me armë;
- zh. vepra penale ka rezultuar me pasojë të rëndë fizike ose psikike për viktimën;
- z. autori ka qenë paraprakisht i dënuar për vepra të kësaj natyre;

Nga aspekti i mbrojtjes civile-juridike të viktimave të dhunës me bazë gjinore, shteti për herë të parë në janar të vitit 2021 miratoi një ligj në të cilin njihen të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, ku parashihet mbrojtje specifike për të gjitha gratë viktimë të formave të ndryshme të dhunës përmes vendosjes së shërbimeve të specializuara për ndihmë dhe përkrahje. Përgatitja dhe miratimi i ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, ishte paraparë edhe me Planin Nacional të Veprimit për implementimin e Konventës së Stambollit, ndërsa si qëllim kryesor i saj është avancimi i sistemit për mbrojtjen e grave viktimë nga format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore.

Fjalorthi i ligjit në nenin 3, në mënyrë specifike i definoi se çfarë përfshin dhe çfarë nënkupton "dhuna ndaj grave" (paragrafi 1), "dhuna me bazë gjinore" (paragrafi 2), "dhuna në familje" (paragrafi 3) dhe "dhuna intime e partnerit" (paragrafi 5). Ligji i ri e definoi riintegrimin e viktimave të dhunës (neni 99), për herë të parë në sistemin e mbrojtjes nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, ku përmes një programi të posaçëm për riintegrimin e viktimave të dhunës, do të sigurohen këto shërbime: akomodimi i përkohshëm, këshillimi psikologjik me mentor, lloje të ndryshme të ndihmës financiare, dedikuar në veçanti për gratë që janë viktimë të dhunës, mundësi për arsimim dhe trajnim në sfera të ndryshme, si dhe masa për punësim, që përcaktohen me ligj. Sipas këtij neni, institucionet kompetente do të obligohen që të zbulojnë viktimat e dhunës në familje si një kategori e posaçme e rrezikuar dhe të zhvillojnë programe dhe masa në pajtim me nevojat specifike të grave viktimë të dhunës.

Një prej përmirësimeve më të rëndësishme që janë rregulluar me këtë ligj është parimi i vëmendjes së detyrueshme që i obligon të gjithë pjesëmarrësit në sistemin e mbrojtjes, t'i ndërmarrin të gjitha masat përkatëse ligjvënëse, administrative, gjyqësore dhe masa të tjera për të parandaluar, mbrojtur, hulumtuar, dënuar dhe të siguruar kompensim të drejtë për viktimat ose kthimin në statusin fillestar të veprimeve të dhunës që janë kryer nga personat fizikë ose juridikë¹⁷.

Parimet themelore të ligjit janë mosdiskriminimi, ndalimi i viktimizimit, gratë e rrezikuara, përshtatja adekuate e grave me aftësi të kufizuara, politikë të përgjegjshme gjinore dhe fuqizimin e grave që janë viktimë të dhunës.

Në raport me sistemin civil të mbrojtjes, Qendrat për Punë Sociale (QPS) i kanë të njëjtat kompetenca sikurse edhe me ligjin paraprak. Masat mbrojtëse që ndërmerren nga QPS në nenin 46 zgjerohen në këtë mënyrë: a) siguron përkujdesje të përkohshme; b) siguron se viktimat do të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore dhe, sipas nevojës, të shoqërohet deri te qendra më e afërt shëndetësore; v) sigurohet se viktimat e ka realizuar të drejtën për mbrojtje sociale dhe shëndetësore në pajtim me ligjin; g) siguron intervenim dhe trajtim adekuat psiko-social, d) siguron që viktimat të marrë trajtim psiko-social gjatë këshillimit nga ekspertët e qendrës për punë sociale, shoqatat, këshillimi i femrave viktimë të dhunës dhe viktimat e tjera të dhunës në familje; gj) siguron ndihmë për

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, që mund të merret në [link](#)

¹⁷ Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, që mund të merret në [link](#)

familjen për shkollimin e rregullt të fëmijëve; e) siguron ndihmë dhe përfaqësim juridik; zh) e orienton viktimën ndaj trupave përkatëse shtetërore dhe atyre kompetente për forcimin ekonomik të viktimës dhe përfshirjen aktive në tregun e punës, pranë një qendre kompetente të punësimit dhe, z) në rast të rrezikut të lartë dhe masave urgjente për mbrojtje, si dhe kur viktima shfrytëzon shërbimet për qëndrim të përkohshëm, më së voni në afat prej 12 orëve nga pranimi i denoncimit, miraton vendim për dhënien e përkohshme për kujdes dhe edukim të fëmijëve që janë viktima të dhunës prindërore.

Megjithëse ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje, është një ligj civil që drejtpërdrejtë nuk i rregullon vrasjet si vepra penale, por rëndësia e tij del nga fakti se respektimi dhe zbatimi i plotë i dispozitave do të kontribuojë për parandalimin e femicideve.

METODOLOGJIA

Realizimi i Analizës së vrasjeve të grave - Femicideve, është zhvilluar në katër faza.

Faza e parë - analiza e rregullativës ligjore përfshin shqyrtimin e dokumenteve relevante ligjore me fokus në Kodin Penal dhe praktikave ndërkombëtare, si dhe analizave dhe hulumtimeve të publikuara me fokus të njëjtë ose të ngjashëm, nga rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe shtetet evropiane. Si rezultat i shqyrtimit të dokumenteve të lartpërmendura, është propozuar përkufizimi më adekuat për këtë lloj të veprave penale, e cila mund të shfrytëzohet në kontekst kombëtar.

Faza e dytë - analiza e rasteve individuale e vrasjeve të grave. Hapi i parë që nevojitet të realizohet para se të fillohet me analizën e rasteve individuale ishte identifikimi i numrit të grave të vrara në periudhën mes viteve 2017-2020. Përvoja e ekipit të hulumtimeve gjatë përgatitjes së studimit të parë të femicideve¹⁸ është se të dhënat më relevante për numrin e vrasjeve të grave në nivel vjetor, mund të gjinden në ueb faqen e Entit Shtetëror të Statistikës, ndërsa numri i tentimeve për vrasje mund të merret nga shqyrtimi i buletineve ditore të MPB-së.

Pas identifikimit të numrit të gravetë vrara në periudhën që është lëndë e kësaj analize, vazhdohet me identifikimin e viktimave, respektivisht komunës/zyetit ku ka ndodhur vrasja. Këto informata janë marrë nga shqyrtimi i detajuar i publikimeve mediatike dhe buletineve ditore të MPB-së. Kjo ishte mënyra e vetme që të mblidhen këto informata sepse gjykatat nuk mblidhin të dhëna për gjininë e viktimës, ndërsa të dhënat me të cilat disponon Ministria e Punëve të Brendshme, që kanë lidhje me vendin e vrasjes, janë të ndara sipas Sektorëve për Punë të Brendshme (SPB) që nuk janë njësoj të organizuara sikurse Gjykatat themelore me kompetencë të zgjeruar, përgjegjëse për këtë lloj të veprave penale. SPB-të nuk janë njësoj të organizuara as me Prokuroritë Publike me kompetenca të zgjeruara që janë përgjegjëse për këtë lloj të veprave penale.

Hapi i radhës ishte përgatitja dhe paraqitja e kërkesave për shqyrtimin e lëndëve gjyqësore në të gjitha gjykatat me përgjegjësi të zgjeruar ku janë identifikuar rastet e vrasjeve të femrave në periudhën e viteve 2017-2020. Kërkesat për shqyrtim u dërguan edhe në Prokuroritë Publike për shqyrtimin e lëndëve ku autori është vetëvrarë pasi e ka kryer vrasjen.

Në drejtim të mbledhjes sistematike të të dhënave, u përpilua edhe një pyetësor i strukturuar të cilin e plotësonin hetuesit gjatë secilit hetim të bërë të lëndëve. Pyetësori i strukturuar i përmban këto indikatorë:

- ☛ Mosha dhe gjinia e viktimës dhe autorit
- ☛ Angazhimi me punë i viktimës dhe autorit
- ☛ Lloji i raporteve ndërmjet viktimës dhe autorit
- ☛ Lloji i aftësisë së kufizuar (nëse ekziston) i viktimës dhe autorit
- ☛ Ekzistimi i dhunës
- ☛ Metoda e vrasjes
- ☛ A ka qenë arma e regjistruar
- ☛ A ekziston leje për shfrytëzim
- ☛ A është dhënë leja për qëllime private apo zyrtare (nëse është zyrtare, nga cili institucion është lejuar)
- ☛ Vendi i kryerjes së vrasjes
- ☛ Motivi i vrasjes
- ☛ A ka pasur viktimë ose dëshmitarë të tjerë
- ☛ Gjendja psikike e autorit
- ☛ Neni nga Kodit Penal sipas të cilit është kualifikuar vepra/akuza e parashtruar
- ☛ Kohëzgjatja e procedurës gjyqësore
- ☛ Lartësia e dënimit të shqiptuar

¹⁸ Analiza e femicideve - vrasjeve të grave në Republikën e Maqedonisë, Rrjeti Nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2018, që mund të merret në [link](#)

Faza e tretë - analiza e raportimeve mediatike

Analiza e parë e femicideve - vrasjeve të grave në Republikën e Maqedonisë (2008-2016) që është realizuar nga Rrjeti Kombëtar kundër dhunës ndaj grave, tregoi se publikimet mediatike janë faktografike, pa një analizë më të thelluar të rasteve, nuk shfrytëzojnë gjuhë të mjaftueshme senzitive gjinore, nuk e njohin vrasjen si formë e dhunës me bazë gjinore dhe më së shpeshti shfrytëzojnë tituj që janë sensacional dhe për të tërhequr vëmendjen e lexuesve.

Analiza e raportimeve mediatike ka për qëllim që të tregojë se a ka ecur përpara në raport me këtë temë, respektivisht a ka përparuar mënyra e raportimit. Si rezultat i analizës së raportimeve mediatike janë përgatitur rekomandimet konkrete për përmirësimin e tyre.

Faza e katërt - Përmbledhja e të dhënave dhe përgatitja e raportit final

Në fazën e fundit të përgatitjes së Analizës, pasi janë mbledhur të gjitha të dhënat sipas hapave të përshkruara paraprakisht, u përpilua edhe raporti final që përbëhet nga konstatimet e të dhënave të analizuar, konkluzionet dhe rekomandimet për avancim.

Raporti final do të prezantohet para përfaqësuesve të institucioneve relevante.

KONSTATIMET

Pas shqyrtimit të realizuar të informatave të disponueshme në pjesën Popullsia - Persona të vdekur nga vdekja e dhunshme¹⁹, janë publikuar në ueb faqen e Entit Shtetëror të Statistikës, kemi të dhëna se numri i grave të vrara në periudhën e analizuar është gjithsej 26.

Në tabelën 1 janë prezantuar të dhënat e marra nga Enti Shtetëror i Statistikës, respektivisht numri i grave të vrara, të ndara sipas viteve, si dhe arsyeve të vdekjes.

Tabela 1: Numri i përgjithshëm i grave të vrara në periudhën 2017-2020 sipas arsyeve të vdekjes.

Arsyet e vdekjes	2017	2018	2019	2020
Tentim për shkakimin e lëndimit trupor me varje, strangulim dhe asfiksion	1	1		
Tentim për shkakimin e lëndimit trupor me ngufatje dhe zhytje	1		1	
Tentim për shkakimin e lëndimit trupor me qitje nga pistoletat		5	1	
Tentim për shkakimin e lëndimit trupor me qitje nga pushka ose armë më e madhe e zjarrit	1			1
Tentim për shkakimin e lëndimit trupor me qitje nga një armë tjetër dhe armë e pashënuar e zjarrit		1		1
Tentim për shkakimin e lëndimit trupor me forcë trupore				
Tentim për shkakimin e lëndimit trupor me sende të mprehta	1	1		
Tentim për shkakimin e lëndimit trupor me sende jo të mprehta	2			
Tentim për shkakimin e lëndimit në mënyrë të pacaktuar	3	1	2	2
Gjithsej	9	9	4	4

Pas identifikimit të numrit të grave të vrara për periudhën 2017-2020, u bë shqyrtimi i detajuar i buletineve ditore të MPB-së dhe publikimeve mediative gjatë kësaj periudhe. Duke i krahasuar informatat e disa medimeve janë marrë edhe informata më të detajuara si emri dhe mbiemri/inicialet e viktimës dhe autorit ose fillimisht të dyshuarit, raporti ndërmjet viktimës dhe autorit, vendi dhe mënyra e shkakimit, ndërsa në disa raste edhe motivi i vrasjes.

Në këtë mënyrë janë siguruar të dhënat themelore për 25 gra të vrara.

U parashtruan kërkesa për qasje dhe shqyrtimin e lëndëve gjyqësore për rastet e identifikuara të femrave të vrara deri te Gjykatat Themelore me kompetencë të zgjeruar me seli në Shkup, Tetovë, Gostivar, Koçan, Manastir, Veles, Ohër dhe Prilep, e për të cilat u konstatua se ka raste të vrasjeve të grave. Pozitivisht u përgjigjën të gjitha gjykatat, me përjashtim të Tetovës, të cilët edhe përkundër lajmërimeve të shumta nuk u përgjigjën në kërkesat për qasje për shqyrtim të një lënde të vrasjes që kishte ndodhur në vitin 2018.

Sfida që u paraqit gjatë realizimit të shqyrtimeve është mosekzistimi i lëndëve gjyqësore për dy vrasje edhe atë në Gostivar dhe Koçan. Në mënyrë shtesë, jo të gjitha gjykatat lejuan qasje në të gjitha lëndët, me arsyetimin më të shpeshtë se nuk mund t'i gjejnë. Dy lëndë ishin ende në vijim, respektivisht ishin miratuar aktgjykimet e para që ishin ankimuar nga autori dhe procedura kishte vazhduar në Gjykatën e Apelit. Për gjithsej 10 raste nuk u lejuan qasje në lëndët gjyqësore.

Për shkak të periudhës së shkurtër kohore të paraparë për këtë pjesë të analizës, hulumtuesit nuk kishin mundësi që të mbledhin informata se çfarë kishte ndodhur në procedurat për vrasjet që nuk kanë procedurë të filluara.

¹⁹ Enti Shtetëror i Statistikës, Informatat për vdekjen e dhunshme, që mund të merret në [link](#)

Në raport me vrasjet e grave që janë pasuar me vetëvrasjen e autorit, u parashtrua kërkesë në Prokurorinë e Lartë Publike - Shkup, të cilët vetëm u përgjigjen se "Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose një person i autorizuar nga ana e tij, mund të lejojnë qasje në shkresat dhe dokumentet e arkivuara të prokurorisë publike" dhe kërkesa e Rrjetit është transferuar deri te Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përkundër disa tentimeve, hulumtuesit nuk arritën që të kontaktojnë dhe të marrin përgjigje nga Prokuroria Publike e RMV-së. Në veçanti u parashtruan kërkesa edhe deri te PTHP e Shkupit (1 lëndë), PTHP e Manastirit (1 lëndë), PTHP e Koçanit (1 lëndë) dhe PTHP e Prilepit (1 lëndë). Përgjigje së bashku me lejen e miratuar për qasje në lëndë morrëm vetëm nga PTHP e Prilepit.

Sipas informatave të para që janë marrë nga shqyrtimet e detajuara të raportimeve mediatike dhe buletinit ditor të Ministrisë së Punëve të Brendshme **është konkluduar se 22 vrasje mund të kualifikohen si femicide.**

Në analizën e parë dhe të dytë, është siguruar qasje në rreth 50% të lëndëve gjyqësore për vrasjen e grave. Më konkretisht, në analizën e parë për periudhën e viteve 2008 deri në 2016 u përfshinë 48.5% nga numri i përgjithshëm i vrasjeve, e që me këtë analizë janë përfshirë rreth 61.5%.

Gjatë vlerësimit të një vrasje nëse mund të kualifikohet si femicide, autorët e kësaj analize kanë marrë parasysh tri kriteret që dalin nga përkufizimet e lartpërmendura për femicidin. Kriteri i parë, bazik është që viktima të jetë grua, ndërsa vrasja të jetë kryer nga partneri intim, i tanishëm ose i mëparshëm, pa marrë parasysh nëse jetojnë ose kanë jetuar në të njëjtën amvisëri, ose nga një anëtar tjetër mashkull i familjes. Kriteri i dytë është motivi i vrasjes - nëse viktima ka qenë qëllimi kryesor i autorit të vrasjes. Dhe motivi i tretë, nëse vrasja do të ndodhte në të njëjtat rrethana por duke i ndryshuar rolet - viktima të jetë autori.

Duke i ndjekur këto kriteret, është bërë konstatimi se 22 vrasje të grave janë femicide, ndërsa 4 nuk hyjnë në këtë kualifikim.

Në fakt, në dy prej vrasjeve që janë kualifikuar si femicide, vepra është kryer nga një fqinj/familjar i bashkëshortit, ndërsa motivi i vrasjes nuk ka bazë gjinore, respektivisht qëllimi nuk ka qenë gruaja e vararë. Në rastin e parë fqinji e ka sulmuar tërë familjen, me ç'rast anëtarët e tjerë kanë marrë lëndime më të lehta, kurse në rastin e dytë qëllimi ka qenë bashkëshorti i gruas së vararë. Në lidhje me dy vrasjet e tjera, institucionet kompetente nuk u përgjigjen ndaj kërkesës për shqyrtim, ndërsa gjatë raportimit mediatik kishte shumë pak informata, që ishin të pamjaftueshme për të përcaktuar motivimin e bazës gjinore të vrasjeve. Gjithsesi, nuk përjashtohet fakti se nëse do të ekzistonin informata të mjaftueshme edhe këto dy raste mund të kualifikohen si femicide.

Tabela 2: Numri i femicideve sipas viteve

	2017	2018	2019	2020	Gjithsejtë
Gjithsej vrasje	9	9	4	4	26
Shqyrtimet e realizuara	5	6	1	4	16
Femicide	7	9	2	4	22

KONSTATIMET NGA SHQYRTIMET E REALIZUARA TË LËNDËVE GJYQËSORE

U parashtruan kërkesa për qasje në Gjykatat Themelore me kompetencë të zgjeruar të Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Koçanit, Manastirit, Velesit, Ohrit dhe Prilepit, si dhe Prokuroritë Themelore Publike të Shkupit, Manastirit, Prilepit dhe Koçanit, për 25 lëndë gjyqësore të grave të vrara gjatë periudhës së viteve 2017-2020.

U realizuan shqyrtime dhe analiza të 16 (gjashtëmbëdhjetë) lëndëve të vrasjeve të grave, prej të cilave 14 (katërbëdhjetë) mund të kualifikohen si femicide.

Gjatë përpunimit të të dhënave të fituara u morrën parasysh edhe mosha dhe gjinia e viktimës dhe autorit, angazhimi i punës së viktimës dhe autorit, raporti ndërmjet viktimës dhe autorit, lloji i aftësisë së kufizuar (nëse ekziston) të viktimës dhe autorit, vendi i kryerjes së vrasjes, motivi i vrasjes, a ka pasur viktimës dhe dëshmitarë të tjerë, gjendja psikike e autorit, neni i Kodit Penal sipas të cilit është kualifikuar vepra/aktakuza e parashtruar, kohëzgjatja e procedurës gjyqësore.

Konstatimet e fituara kanë të bëjnë vetëm me pjesën e lëndëve të analizuara gjyqësore për vrasjet e grave që janë kualifikuar si femicide dhe janë prezantuar sipas indikatorëve të lartpërmendur.

Në aspekt të moshës së viktimës dhe autorit në tabelën e rradhës janë dhënë konstatimet sipas grup moshave.

Tabela 3: Konstatimet sipas grup moshave

Mosha	Viktima	Autori
Deri në 20 vjet		1
21 – 30 vjet	2	2
31 – 40 vjet	3	4
41 – 50 vjet	3	1
51 – 60 vjet	1	2
Mbi 61 vjet	5	3

Krahasuar me Analizën e mëparshme të rasteve të vrasjeve të grave edhe në ato lëndë gjyqësore që janë lëndë e analizës në këtë dokument, nuk ekziston dallim ndërmjet autorit dhe viktimës në raport me punësinë/papunësinë e tyre.

Tabela 4: Përkatësia etnike

Përkatësia etnike	Viktima	Autori
Maqedonase	10	7
Shqiptare	3	4
Rome	2	2
Turke		1

Sipas përkatësisë etnike, pjesa më e madhe e viktimave dhe autorëve janë maqedonas (mbi 70%), ndërsa viktimat tjera janë me përkatësi etnike shqiptare dhe rome. Vetëm 1 autor është i përkatësisë etnike rome.

Megjithëse si pjesë e pyetësorit të strukturuar ishte e përfshirë pyetja për ekzistimin e aftësive të kufizuara të

viktima dhe autori, sidoqoftë në asnjë prej lëndëve të analizuara nuk kishim informata për gjendjen e këtillë.

Konstatimet e fituara në aspekt të raportit ndërmjet viktimës dhe autorit janë të pritshme dhe përputhen edhe me konstatimet e studimit paraprak. Së këndejmi **nga gjithsej 14 (katërbëdhjetë) gra të vrara, 10 (dhjetë) janë vrarë nga partneri i tanishëm ose ish-partneri**. Ndërsa 4 (katër) të tjera janë vrarë nga persona të afërm, anëtarë të familjes më të ngushtë. Një grua është vrarë nga djali i saj, dy gra janë vrarë nga nipat dhe njëra nga një familjar i afërm.

Tabela 5: Raporti ndërmjet viktimës dhe autorit

Lloji i raportit	
Bashkëshort	5
Partnerë jashtëmartesorë	3
Partnerë intimë	1
Ish-bashkëshort/partner	1
Djalë/nënë	1
Nip/gjyshe	2
Anëtarë/farefisë tjerë të familjes	1

Sikurse edhe në analizën e mëparshme, edhe këtë herë fokusi ishte në ekzistimin e denoncimit për dhunë dhe veprimet të institucioneve. Në më shumë se 80% të rasteve megjithëse ka ekzistuar dhunë për të cilën më vonë gjatë procedurës kanë dëshmuar edhe familjarët e afërm të viktimës, prapë se prapë asnjë prej 14 (katërbëdhjetë) grave të vrara nuk e kanë denoncuar dhunën që e ka përjetuar në organet kompetente. Pjesa më e madhe e grave të vrara kanë qenë të ekspozuara në disa forma të dhunës me bazë gjinore, ndërsa 6 (gjashtë) prej tyre janë kërcënuar edhe me vrasje.

Tabela 6: Forma e dhunës që i ka paraprirë vrasjes

Dhuna psikike	9
Dhuna fizike	6
Kërcënime me vrasje	6
Dhuna seksuale	1
Konflikte verbale	3
Dhuna ekonomike	2

Pjesa më e madhe e vrasjeve janë kryer me thikë ku viktimave u janë shkaktuar disa plagë vdekjeprurëse. Gjatë kryerjes së vrasjeve, në 3 raste autori ka shfrytëzuar disa metoda për ta arritur qëllimin final - privimin e viktimës nga jeta. Ndryshimi i metodës së vrasjes ka ndodhur kur metoda e përdorur në fillim nuk ka pasur sukses, andaj autorët kanë vazhduar me atë që e kanë pasur afër dorës - forcën e tyre fizike (ngufatje, goditje me shqelma, bokse)

Tabela 7: Metoda e vrasjes

Goditje me mjet të fortë (boks hekuri, holluese)	2
Plagë shpimi me thikë	5
Goditje me grushte/shqelma	1
Armë zjarri - pistoletë	3
Ngufatje	4
Goditje me sëpate	1
E djegur për së gjalli	1

Në 2 prej tre rasteve ku është përdorur armë zjarri - pistoletë për të kryer veprën penale - vrasje, e njëjta ka qenë e regjistruar, ndërsa autorët kanë poseduar leje për shfrytëzim për qëllim privat. Autori që e ka kryer vrasjen me armë të peregjistruar krahas kësaj veprë penale, është përndjekur edhe për përpunimin, mbajtjen, ndërmjetësimin dhe tregtimin e paautorizuar me armë dhe materie plasëse në pajtim me neni 396 të Kodit Penal.

Krahasuar me konstatimet e analizës së parë, përdorimi i armës së zjarrit për të kryer vrasje është ulur, respektivisht në periudhën nga viti 2008 deri në 2016 nga gjithsej 28 (njëzet e tetë) vrasje të analizuara të grave, 15 (pesëmbëdhjetë) ose 53.5% janë kryer me armë zjarri, ku në 7 (shtatë) raste, autori nuk ka poseduar leje për shfrytëzim, ndërsa në 4 (katër) raste nuk ka informatë për posedimin/mosposedimin sepse autori është vetëvararë menjëherë pasi ka kryer vrasjen. Në periudhën nga viti 2017 e deri më 2020, 21% të vrasjeve janë kryer me armë zjarri, respektivisht 3 (tre) nga 14 (katërmëdhjetë) gra. Vetëm dy autorë kanë poseduar leje për qëllime private.

Në raport me motivin e vrasjes, konstatimet janë të ngjashme me ato nga Analiza e vrasjeve të grave (2008-2016). Si motive më të shpeshta paraqiten raportet konfliktuoze ndërmjet autorit dhe viktimës të cilët kanë qenë në lidhje intime partneriteti, pavarësisht aspektit martesor ose jashtëmartesor, konflikte që mund të ndodhin edhe nga natyra financiare. Së këndejmë në 3 (tre) raste, vrasja është kryer pasi që viktimja ka refuzuar që t'i japë para autorit. Vrasja është pasoja e fundit e dhunës ekonomike që i ka paraprirë.

Varësia nga alkooli dhe drogat dehëse paraqiten si motiv shtesë, më së shpeshti në kombinim me raportet e konfliktit ose çrregullimeve psikike.

Tabela 8: Motivi i vrasjes

Raportet konflikte ndërmjet partnerëve aktual	5
Gjendja/çrregullime psikike	5
Varësia nga alkooli, droga dhe substancat tjera psikotrope	3
Divorci/ndërprerja e lidhjes	3
Konfliktet e natyrës financiare	3

Pjesa më e madhe e vrasjeve (50%) kanë ndodhur në shtëpinë familjare, respektivisht në shtëpinë ku kanë jetuar së bashku viktimja dhe autori, ndërsa 25% e vrasjeve kanë ndodhur në shtëpinë ku viktimja ka jetuar e vetme ose me prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes.

Tabela 9: Vendngjarja e vrasjes

Shtëpia familjare	7
Hapësira publike	2
Shtëpia e viktimës	1
Shtëpia e prindërve/anëtarëve tjerë të familjes së viktimës	3
Shtëpia e autorit	1

Është tmerrues fakti që madje 6 (gjashtë) fëmijë të mitur kanë qenë dëshmitarë të vrasjeve, prej të cilëve 4 (katër) dëshmitarë të drejtpërdrejtë, respektivisht kanë qenë të pranishëm në hapësirën e njëjtë kur autori e ka kryer vrasjen. Fokusi i kësaj analize është vrasja e grave, andaj edhe pyetësi me të cilin janë mbledhur të dhënat për lëndët, nuk ka pasur pyetje për fëmijët, respektivisht pyetja e vetme ka qenë nëse viktimja ka pasur fëmijë. Në vitin 2018 është publikuar studimi kombëtar për parandalimin, identifikimin, paraqitjen dhe udhëzimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve, ku është dhënë një prezantim i mekanizmave nacional për përgjigje. Ky studim e përfshin sistemin civil të mbrojtjes së fëmijëve viktimja të dhunës, por jo edhe sistemi penal-juridik²⁰. Mbledhja e të dhënave për përfshirjen e fëmijëve në procedura penale si dëshmitarë, si dhe të dhënat për mbrojtje që u sigurohet nga institucionet kompetente është një temë për analizë të posaçme që domosdo duhet të realizohet si hap i fundit.

Në aspekt të gjendjes psikike të autorit, gjatë shqyrtimit të lëndëve, në 7 raste është vërejtur ekzistimi i ndonjë lloji të çrregullimit, që është diagnostikuar paraprakisht. Behet fjalë për çrregullime psikike dhe paranoike në stadime të ndryshme që kanë nevojë për trajtime shumëvjeçare. Pothuajse të gjithë të akuzuarit për vepra penale të vrasjeve, gjykata ka kërkuar ekspertiza psikiatrike për gjendjen psikike të autorit dhe gjendjes së tij në momentin e vrasjes.

²⁰ Parandalimi, identifikimi, paraqitja dhe udhëzimi i rasteve të dhunës ndaj fëmijëve: Shqyrtimi i mekanizmave nacional për përgjigje, mund të merret në këtë [link](#)

Tabela 10: Veprat penale sipas të cilave është parashtruar akuza

Neni 123 paragrafi 2 p.2, nl n.12 paragrafi 2	1
Neni 123 paragrafi 2 p.2, nl n.12 paragrafi 1	1
Neni 123 paragrafi 2 p.1 dhe p.2	3
Neni 123 paragrafi 2 p.1	1
Neni 123 paragrafi 2 p.2	6
Neni 123 paragrafi 1	1
Vetëvrasje e autorit	1

Rrethana vështirësuese - vrasje gjatë dhunës në familje është e paraparë në 11 (njëmbëdhjetë) raste, gjatë kualifikimit të veprës.

Gjatë analizës së lëndëve të vrasjes së grave është ndjekur edhe kohëzgjatja e procedurës gjyqësore. Vërehet një veprim i shpejtë i Prokurorisë Publike dhe Gjykatave Themelore gjatë këtyre procedurave. Gjysma e procedurave gjyqësore, më saktë 7 (shtatë) raste të vrasjeve janë përmbyllur në më pak se tre muaj.

Njëra procedurë ende nuk ka përfunduar, lënda disa herë është kthyer dhe madje ka edhe ndryshim të formës së kualifikimit të veprës. Për arsye se lënda ende është e hapur, në këtë analizë nuk mund të jepen detaje rreth vijimit të procedurës.

Shkalla e dënimit të shqiptuar sillet nga 10 (dhjetë) vjet e deri në burgim të përjetshëm (në dy raste), me përjashtim të dy rasteve ku është shqiptuar dënimi - Masë e sigurisë: shërim i detyrueshëm psikiatrik dhe mbajtje në institucion shëndetësor.

Në aspekt të kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore, në 4 (katër) lëndë ka pasur pranim të veprës nga ana e autorëve dhe procedurat kanë përfunduar në një periudhë prej 3 (tre) muajve. Në një lëndë ku bëhet fjalë për autorë me diagnozë të çrregullimit të rëndë psikik, procedura ka përfunduar për 1 (një) muaj dhe është shqiptuar dënimi - Masë e sigurisë: shërim i detyrueshëm psikiatrik dhe mbajtje në institucion shëndetësor. Në dy raste, të akuzuarit kanë parashtruar ankesë ndaj aktgjyqimit, andaj procedurat ende vijnë por Gjykatat Themelore që fillimisht i kanë udhëhequr procedurat gjyqësore e kanë miratuar aktgjykimin për 6 (gjashtë), respektivisht 7 (shtatë) muaj. Gjithashtu edhe kohëzgjatja e procedurave për rastet e tjera të vrasjeve të grave kanë përfunduar në një periudhë prej 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj.

Krahasuar me konstatimet e analizës së mëparshme, vërehet një progres i madh në urgjencën e procedurave, respektivisht analiza e parë tregon se procedurat zgjasin 3 (tre) deri në 20 (njëzet) muaj, me ç'rast më shumë zgjasin vetëm ato raste ku autori ka çrregullim të shëndetit mendor dhe ku nevojitet ekspertizë nga profesionistët.

Nga numri i përgjithshëm i femicideve, ekipi hulumtues mori leje për shqyrtimin e lëndëve gjyqësore të 14 rasteve. Për 7 të tjera, informatat u morën vetëm nga raportimet mediatike. Në pesë raste, autori është bashkëshorti, në një partneri jashtëmartesor, kurse për një vrasje nuk ka informatë për të dyshuarin. Dy vrasje janë kryer me armë zjarri - pistoletë, për të cilën nuk ka informata se a është poseduar me leje. Tre prej autorëve janë vetëvrarë pasi që e kanë kryer vrasjen. Në asnjë prej raportimeve mediatike nuk kishte informatë për motivin e mundshëm të vrasjes.

FEMICIDET DHE ARMËT E ZJARRIT

Gratë më së shpeshti janë viktima të keqpërdorimit dhe përdorimit jo të drejtë të armëve të zjarrit, veçanërisht gjatë dhunës në familje, ndërsa meshkujt në shumicën e rasteve janë autorë të këtyre veprave. Në përgjithësi, në Evropën Juglindore më shumë se 95% të armëve të zjarrit i posedojnë meshkujt, ndërsa gratë më pak se 5%²¹. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përqindja është edhe më e lartë, respektivisht 99.5% të armatimit të përgjithshëm është në posedim të burrave, ndërsa gratë posedojnë vetëm 0.5%²²

Sipas studimit të publikuar të SEESAC (Shtëpisë së kliringut të Evropës Lindore për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SEESAC)²³- Keqpërdorimi i armëve të zjarrit gjatë dhunës në familje në Evropën Juglindore²⁴, femicidet janë forma më e shpeshtë e vrasjeve të kryera nga anëtar i familjes. Në këtë dokument është shpjeguar se me "anëtar i familjes" nënkuptohet a) partnerët martesor të mëparshëm ose të tanishëm; b) fëmijët, prindërit dhe anëtarët tjerë në lidhje gjaku, anëtarët e birësuar; v) persona që kanë jetuar ose jetojnë në të njëjtën amvisëri; g) persona që kanë qenë ose janë në ndonjë lidhje emocionale ose seksuale, kanë fëmijë të përbashkët ose presin që të lindin fëmijë edhe pse asnjëherë nuk kanë jetuar së bashku.

Sipas konstatimeve të studimit, 61% të të gjitha grave të vrara, janë vrarë nga një anëtar i familjes, ndërsa tek burrat kjo përqindje është 12.4%, që si informatë e konfirmon konstatimin e analizave dhe hulumtimeve të tjera, se gratë më së shpeshti janë vrarë nga persona të besueshëm. Analiza e femicideve që është realizuar në Maqedoni, tregon se mbi 80% e grave të vrara, janë vrarë nga një anëtar i familjes sipas kriterëve të lartpërmendura, që përfshihen nga ky nocion.

Më tutje, sipas konstatimeve të studimit, nga numri i përgjithshëm i grave dhe burrave të vrarë, partneri intim është autor i dhunës në 38.6% të rasteve të grave të vrara dhe 1.2% të burrave të vrarë. Në veçanti brengosin të dhënat se në 68.9% të rasteve të femicideve, vrasja ka ndodhur në shtëpi, që e zvogëlon mundësinë e viktimit për të ikur.

Në Evropën Juglindore, sipas konstatimit të të njëjtit studim, në 36.5% të rasteve të vrasjes së grave, vepra është kryer me armë zjarri nga ana e një anëtarit të familjes, ndërsa partneri intim është autor i veprës në 43.5% të rasteve të vrasjeve të grave me armë zjarri. Analiza e femicideve në Maqedoni tregon se mbi 30% e vrasjeve të grave janë kryer me armë zjarri²⁵.

Në aspekt të marrjes së lejes për posedimin të armës së zjarrit, studimi tregon se në Evropën Juglindore, vetëm 8.5% e aplikuesve janë refuzuar me bazë se janë ushtrues të dhunës në familje. Ndërsa vetëm në 2.3% të lejeve të revokuara për armë zjarri, si arsye është theksuar dhuna në familje.

Ndoshta edhe një prej konstatimeve më të rëndësishme në këtë studim, është fakti se keqpërdorimi i armëve është paraqitur në vetëm 0.3 përqind të kallëzimeve të regjistruara penale për dhunë në familje, që vetëm se e konfirmon faktin se numri jozyrtar është shumë më i madh.

Një hulumtim me fokus të ngjashëm është realizuar edhe në Serbi²⁶, ku konstatimet tregojnë se çdo i pesti femicid është kryer me armë zjarri (21.1% nga numri i përgjithshëm i femicideve). Një prej konstatimeve kryesore është se ekziston një rrezik dukshëm më i madh për gruan që të jetë viktimitë e dhunës me armë zjarri nga ana e partnerit ose një anëtarit tjetër i familjes. Së këndejmi, pothuajse 95% e rasteve të femicideve të përfshira me këtë hulumtim, 84% e tentimeve për femicide dhe 86% e kërcënimeve me armë zjarri, janë kryer nga partneri intim.

21 Gender and SALW in South East Europe mund të merret në [link](#)

22 Gjinia dhe armët e vogla në Maqedoninë e Veriut, mund të merret në [link](#)

23 Shtëpia e kliringut për Evropën Juglindore dhe Lindore për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (CEEAC) është një iniciativë e përbashkët e Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Këshillit për bashkëpunim rajonal (RCC) që ka për qëllim të forcojë kapacitetet nacionale dhe rajonale për kontroll dhe uljen e proliferimit dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, në këtë mënyrë duke kontribuar për forcimin e stabilitetit, sigurisë dhe zhvillimit të Evropës Juglindore dhe Lindore.

24 The misuse of firearms in domestic violence in South east Europe mund të merret në [link](#)

25 Konstatimi për Maqedoninë e përfshinë periudhën nga vitet 2008-2020.

26 Analysis of cases of femicide committed with firearms mund të merret [link](#)

PREZANTIMI MEDIATIK I RASTEVE TË FEMICIDEVE NË MAQEDONI

Mediumet janë një prej aktorëve kryesorë për ndërgjegjësim për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht gjatë kësaj kohe të pandemisë. Raportimet mediatike për këtë temë, përfshirë edhe raportimin për femicidet, si forma më e rëndë e dhunës me bazë gjinore, kanë rol kryesor në krijimin dhe realizimin e analizave sociale për arsyet dhe pasojat e formave të ndryshme të dhunës. Mediumet mund të ndikojnë edhe në politikat që krijohen dhe miratohen nga ana e institucioneve shtetërore në lidhje me të drejtën penale.

Raportimi mediatik ndër vite, në lidhje me këtë temë ndryshohet, avancohet, por jo mjaft sa që të prezantojë femicidet si pjesë e një problemi më të madh shoqëror në lidhje me dhunën ndaj grave dhe pabarazive të ngulitura ndërmjet burrave dhe grave. Qëllimi i medimeve është që të iniciohen çështjet, të informojnë, edukojnë dhe ndihmojnë mirëkuptimin e popullsisë në përgjithësi, për temat sociale dhe shoqërore me interes, duke nxitur dialog dhe më e rëndësishmja, të shërbejnë si katalizatorë të ndryshimeve.

Për të arritur këtë, mediumet duhet të edukohen dhe sensibilizohen se si të raportojnë në mënyrë të paanshme për çështjet gjinore dhe dhunën në bazë gjinore, duke shmangur viktimizimin dhe stigmatizimin e grave dhe viktimave të dhunës²⁷. Në të kundërtën, mediumet do të kontribuojnë për forcimin e stereotipave, paragjyqimeve duke krijuar një pasqyrë të gabuar për rrënjët e dhunës në bazë gjinore, ku dominojnë narrativët që arsyeja për rastin të kërkohet te viktima, e jo te autori ose mosveprimi i institucioneve. Narrativi me të cilin kërkohet arsyetim për autorin, duke e prezantuar si person përgjegjës, të vyeshëm, të qetë, i respektuar nga fqinjët, bën që publiku të orientohet për të kërkuar fajin dhe përgjegjësinë nga viktima, respektivisht se çfarë ka bërë ajo për ta shqetësuar atë njeri të qetë. Këto narrative mund të kontribuojnë për rritjen e rrezikut për dhunë, duke rritur numrin e femicideve si formë më e rëndë.

Me qëllim të identifikimit të grave që janë vrarë në periudhën e viteve nga 2017 deri në 2020, ndërsa për shkak të mungesës së bazës adekuate me të dhëna që mund të japin këtë lloj të informatave, është bërë një shqyrtim i detajuar i raportimeve mediatike për këtë periudhë. Të njëjtat, krahas asaj që ndihmuan në hulumtimin e qëllimit të parë, u shfrytëzuan edhe për analizën e tekstit të raportimeve. Qëllimi i analizës ishte që të konstatohet nëse ka përmirësime për mënyrën e raportimit të rasteve të femicideve - vrasjeve të grave, duke i krahasuar konstatimet me analizën e parë. Në këtë proces janë përfshirë 88 raportime mediatike.

Gjatë analizimit janë marrë parasysh këto indikatorë:

- ekzistimi i informatave personale për autorët dhe viktimat (emri dhe mbiemri, mosha, vendbanimi),
- përdorimi i akuzave të drejtpërdrejta ose indirekte ndaj viktimës,
- kontekstualizimi i rasteve femicide si probleme individuale ose si pjesë e një çështjeje më të gjerë që ka lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe/dhunën e partnerit intim.

Në mënyrë plotësuese analiza ka përfshirë edhe ekzistimin e informatave në lidhje me procesin dhe aktgjykimin gjyqësor, respektivisht ekzistimin e raportimeve mediatike për rrjedhën e procesit gjyqësor dhe dënimit final për autorin.

Ajo që duket nga raportimet mediatike për vrasjet e grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është prezantimi faktografik i rastit përmes informatave të marra nga buletinet ditore të MPB-së. Të gjitha raportimet mediatike janë pothuajse të njëjta, shpeshherë me tekst që është identik me tekstin e buletinit ditore të MPB-së. Në të gjitha raportimet mungojnë fokusimi i vrasjes si një formë e dhunës në bazë gjinore, ndërlikueshmëria e dhunës si dukuri dhe problem shoqëror, arsyeja dhe pasojat, sqarimi i termit femicid.

Në raport me të dhënat personale, pothuajse në të gjitha raportimet theksohen inicialet, mosha dhe vendbanimi

²⁷ Udhëzuesi për raportim të ndjeshëm gjinor në medime, mund të merret në [link](#)

i viktimës dhe autorit, si dhe informata për raportin e tyre.

Në mënyrë shtesë, gjatë të gjitha raportimeve mungon informata për veprimin e institucioneve, mendimi sipas kodit penal, dokumentet e ratifikuara ndërkombëtare në lidhje me këtë temë, si dhe dënimet e mundshme dhe të pritshme për autorin. Mungojnë deklaratat/intervistat me ekspertët nga sfera ose edhe deklaratat e personave përgjegjës të institucionet. Për asnjë prej femicideve nuk është gjetur një raportim i vazhdueshëm për procesin gjyqësor ose dënimin e shqiptuar për autorin.

Krahasuar me konstatimet nga analiza e parë, dallimi i vetëm ishte në titujt e raportimeve mediatike. Së këndejmi, në periudhën e përfshirë me këtë analizë (2017-2020), terminologjia dhe përshtatja e vrasjeve me "dramë dashurie", "dramë familjare" dukshëm është zvogëluar, por prapë se prapë ekziston.

„Dramë familjare me fund tragjik në Prilep: MPB-ja me detaje për vrasjen e dyfishtë.”

Ajo që vërehet është narrativi i ndryshuar që shfrytëzohet gjatë raportimit sensacional, veçanërisht gjatë krijimit të titujve, që kanë për qëllim ta tërheqin lexuesin për ta hapur linkun, edhe pse vetë teksti nuk ka shumë informata për këtë ngjarje. Kështu, shumë tituj të raportimeve mediatike për vrasjen e grave e përfshijnë mënyrën e kryerjes së vrasjes, si dhe raportin e viktimës dhe autorit.

„Për vrasjen e gruas në Manastir është i dyshuar bashkëshorti i saj, e ka vrasë me holluese”

„Një shkupjane ka vdekur pasi është rrahur nga bashkëshorti”

„Nipi e ka vrasë gjyshen me një boks prej hekuri - paraburgim 30 ditor për vrasësin”

„Tmerr në Maqedoni: Me thikë e ka vrasë partneren para syve të fëmijës dhjetëvjeçar”

„vrasje në Draçevë: Nipi e ka therur gjyshen ”

„Koçanasi e ka therur gruan me thikë, e më pas e ka vrasë me një çekiç - tërë këtë e ka parë fëmija i mitur ”

Një pjesë e titujve shfrytëzojnë edhe fjalë që nga njëra anë shkaktojnë terror te lexuesi, por njëkohësisht nxisin kuriozitet për të mësuar detajet e vrasjes. Por, shumë pak raportimet mediatike me të vërtetë sigurojnë informata esenciale dhe të rëndësishme për ngjarjen e përshkruar sipas titullit.

„Një grua e vdekur është gjetur në Qendër - janë dëgjuar britma për ndihmë”

„Vrasje në Manastir, një grua është gjetur e gjakosur në banesën e saj”

„Detaje për gruan e vrasë në Gostivar: E kishte therur me thikë, pamjet ishin tronditëse”

„Krimi makabër Të enjten e Madhe e tronditi Maqedoninë - detajet e vrasjes”

„Ohër: Nënë e dy fëmijëve është vrasë gjatë mesditës në shtëpinë e saj”

„Punonte si roboqepëse dhe kishte qenë në lidhje: Kush dhe pse e vrau gruan 47 vjeçare në Ohër”

Mbetet çështje e hapur nëse këto ngjarje, vrasje të grave paraqiten në medime vetëm për të marrë më shumë klikime (hapje të ueb faqes).

Aspekti pozitiv i analizës së raportimeve mediatike është se nuk vërehet fjalor i cili drejtpërdrejt ose indirekt i akuzon viktimat për ngjarjen, si dhe nuk ka komente për karakterin e autorit (me një përjashtim²⁸), që nga njëra anë mund të jetë rezultat i sensibilizimit dhe edukimit të medimeve përmes trajnimeve që realizohen nga organizatat civile. Por nga ana tjetër, duke marrë parasysh se raportimet mediatike janë vetëm faktografike dhe me tekste të marra nga buletinet e MPB-së, raportimi i këtillë potencon se nuk kuptohen mjaftueshëm, nuk ka interesim, pasuar me një përkushtim të ulët të medimeve në lidhje me këtë temë.

Në fund të kësaj pjese, mund të veçojmë raportimin e vetëm mediatik ku është përdorur nocioni "femicid" ku për këtë qëllim është realizuar edhe intervistë me një ekspert të fushës, respektivisht është paraqitur lidhja e dhunës me bazë gjinore me vrasjen e kësaj gruaje. Edhe pse gazetari/gazetarja këtë tekst ka mundur që ta plotësojë me informata për legjislaturën nacionale, Konventën e Stambollit dhe sistemin ekzistues për mbrojtjen e viktimave

²⁸ E kishte therur me thikë, pastaj i kishte kërkuar fqinjët - dëshmi për vrasjen në Prilep | Press24

të dhunës në familje, në mënyrë që të informojë viktimat se ku të kërkojnë ndihmë, prapë se prapë ky raportim mediatik mund të veçohet si një shembull pozitiv gjatë përgatitjes së publikimeve me përmbajtje të njëjtë ose të ngjashme në të ardhmen.

„ Vrasja e djeshme në Koçan, femicidi i parë në vitin 2018”²⁹

Vrasja e djeshme e bashkëshortes me thikë dhe çekiç nga bashkëshorti i saj 54 vjeçar, që ndodhi në orët e hershme të mëngjesit në Koçan, është rasti i parë i femicidit në vitin 2018, konsiderojnë ekspertët.

Sipas Bllagica Kirova nga organizata joqeveritare “EHO” nga Shtipi, e cila punon me viktimat e dhunës në familje, drama e përgjakshme që ka ndodhur dje ku është vrarë një grua e më pas edhe bashkëshorti është vetëvrarë, është një shembull klasik i cili e pasqyron dimensionin gjinor të dhunës në familje.

- Femicidi është forma më e rëndë e diskriminimit të grave. Ajo paraqet një vrasje të gruas vetëm sepse është grua. Forma më e rëndë e dhunës ndaj grave dhe vajzave, shprehet Kirova.

Krahas asaj që institucionet kompetente nuk kanë regjistruar dhunë në atë familje nga Koçani, sipas Kirovës, akti i këtyllë është rezultat i torturës shumëvjeçare psikike dhe fizike që ishte fshehur nga institucionet.

- Informatat që kemi flasin se shpeshherë dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave mbetet e fshehur brenda familjes. Domethënë, nuk paraqitet zakonisht për shkak të paragjyqimeve tek vetë gratë për ta ruajtur imazhin e një familje normale, funksionale. Si arsye se pse nuk i paraqesin rastet gratë është edhe fakti që fëmijët të mos lihen vetëm, e pastaj të rriten në rrethana të vështira. Si një person që merrem një kohë të gjatë me këtë problematikë, konsideroj se ky nuk është rast që ka ndodhur aksidentalisht mbrëmë, shtoi Kirova.

Në Maqedoni nuk ka statistikë zyrtare për femicidet, por sipas një analizës të realizuar nga organizatat joqeveritare gjatë tre muajve të kaluar në nivel shtetëror janë regjistruar 19 raste të femicidit.

²⁹ [Vrasja e djeshme në Koçan, femicidi i parë në vitin 2018](#) | Press24

KONKLUZIONET

Mbledhja e të dhënave për vrasjet e grave është një proces jashtëzakonisht i vështirë dhe i gjatë. Kjo është rezultat i mosekzistimit të një sistemi për mbledhjen e të dhënave për këtë formë më të rëndë të dhunës së bazuar në gjini, edhe pse sistemi nuk ekziston as edhe për format e tjera të dhunës ndaj grave. Në mënyrë plotësuese, është e pamundur të bëhet një analizë e tërësishme, gjithëpërfshirëse dhe e plotë për të gjitha femicidet në nivel nacional, për shkak të mos reagimit të disa gjykatave dhe prokurorive publike në lidhje me mundësimin e qasjes dhe shqyrtimin e lëndëve gjyqësore për rastet e vrasjeve të grave.

Së këndejmë, edhe në analizën e parë dhe të dytë, është siguruar qasje në rreth 50% të lëndëve gjyqësore të vrasjeve të grave. Më konkretisht, me analizën e parë për periudhën 2008 deri në 2016 ishin përfshirë 48,5% të numrit të përgjithshëm të vrasjeve, ndërsa në këtë analizë janë përfshirë 61,5%.

Në periudhën 2017-2020 janë vrarë gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) gra, sipas të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikës. Prej tyre, 22 (njëzet e dy) vrasje (84%) mund të kualifikohen si femicide.

Nga shqyrtimi i realizuar i lëndëve për vrasjet e 16 (gjashtëmbëdhjetë) grave, vepra penale mund të kualifikohet si femicid në 14 (katërbëdhjetë) raste.

Më shumë se 75% e rasteve të analizuara të vrasjes së grave, vepra penale është kryer nga ana e partnerit aktual ose ish-partnerit martesor ose jashtëmartesor me të cilin kanë jetuar në bashkësi.

Në mbi 80% të rasteve, megjithëse ka ekzistuar dhunë për të cilën më vonë në procedurë kanë dëshmuar edhe familjarët e afërt të viktimës, **megjithatë asnjë prej 14 (katërbëdhjetë) grave të vrara nuk e ka denoncuar në organet kompetente më herët, dhunën e përjetuar.** Pjesa më e madhe e grave të vrara ishin ekspozuar ndaj disa formave të dhunës së bazuar në gjini, ndërsa 6 (gjashtë) prej tyre ishin kërcënuar edhe me vrasje.

Pjesa më e madhe e vrasjeve (50%) kanë ndodhur në shtëpinë familjare, respektivisht në shtëpinë ku autori dhe viktima kishin jetuar së bashku, ndërsa 25% e vrasjeve kanë ndodhur në shtëpinë ku viktima kishte jetuar e vetme ose me prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes. Ky konkluzion është vetëm një konfirmim se gratë në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë më të pasigurta në shtëpitë e tyre.

Nuk ekziston dallim i konsiderueshëm ndërmjet autorit dhe viktimës në raport me gjendjen e tyre ekonomike, respektivisht punësimin/papunësinë. Ndërsa, sipas përkatësisë etnike, pjesa më e madhe e viktimave dhe autorëve janë maqedonas (mbi 70%), ndërsa viktimat e tjera janë me përkatësi etnike shqiptare dhe rome.

Shfrytëzimi i armëve të zjarrit për të kryer vrasjen shënon një rënie, respektivisht në periudhën nga viti **2008 deri në vitin 2016 nga gjithsej 28 vrasjet e analizuara të grave, 15 (pesëmbëdhjetë) ose 53.5% janë kryer me armë zjarri,** për të cilën në 7 (shtatë) raste autori nuk ka poseduar leje për përdorim, ndërsa në 4 (katër) raste nuk ka ekzistuar informatë për posedim/mos posedim sepse autori është vetëvrarë menjëherë pasi që kishte kryer vrasjen.

Në periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2020, 21% e vrasjeve janë kryer me armë zjarri, respektivisht 3 (tre) prej 14 (katërbëdhjetë) grave. Vetëm dy autorë kanë poseduar leje për qëllime private.

Kemi të dhëna tmerruese se madje 6 (gjashtë) fëmijë të mitur kishin qenë dëshmitarë të vrasjeve, prej të cilëve 4 (katër) dëshmitarë të drejtpërdrejtë, respektivisht të pranishëm në të njëjtën hapësirë kur autori e ka kryer vrasjen.

Rrethana vështirësuese - vrasje gjatë dhunës në familje është paraparë gjatë kualifikimit të veprës në 11 (njëmbëdhjetë) raste prej gjithsej 14 (katërbëdhjetë) ku është bërë shqyrtimi, të cilat mund të kualifikohen si femicide. Nëse krahasohen konstatimet e analizës së parë të vrasjeve të grave, mund të konkludohet se ekziston një hap pozitiv nga prokurorët publikë për të njohur dhunën e bazuar në gjini gjatë kualifikimit përkatës të veprës penale.

Mbetet e hapur çështja se pse njëri prej dy rasteve nuk është kualifikuar si vrasje gjatë dhunës në familje, veçanërisht nëse merret parasysh raporti në mes të viktimës dhe autorit. Bëhet fjalë për partnerë të mëparshëm intim, që kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore, por që ishin të ndarë kur kishte ndodhur vrasja.

Shkalla e dënimit të shqiptuar sillet nga 10 (dhjetë) vite e deri në burgim të përjetshëm (në dy raste), me përjashtim të dy rasteve ku është shqiptuar dënimi - Masa e sigurisë: mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe mbajtje në një institucion shëndetësor.

Krahasuar me konstatimet e analizës paraprake, vërehet një përparim i vogël në urgjencën e procedurave, respektivisht analiza e parë tregon se procedurat zgjasin nga 3 (tre) deri në 20 (njëzet) muaj, ku më të gjata janë vetëm ato ku autori ka çrregullim të shëndetit mendor dhe nevojitet ekspertizë nga personat profesional. Konstatimet e kësaj analize treguan se mesatarisht në gjykatë themelore sillen aktgjykime për 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj, që më pas mund të ankimohet dhe procedura të kalojë në Apel.

Kodi Penal i Maqedonisë nuk i njeh femicidet si vepër e posaçme penale, por parasheh vetëm rrethana vështirësuese nëse vrasja është kryer gjatë dhunës në familje, me çka dënimi për autorin sillet nga 10 vite e deri në burgim të përjetshëm. Ndryshimet e propozuara në Kodin Penal, që kanë hyrë në procedurë parlamentare, që kanë lidhje me plotësimin e rrethanave vështirësuese "gjatë ushtrimit të dhunës në familje" me "gjatë ushtrimit të dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore" janë një hap pozitiv, por nuk do të kontribuojnë për njohjen e aspektit gjinor të dhunës dhe grave si viktimat më të shpeshta të vrasjeve nga ana e partnerit të tyre intim ose një anëtar tjetër të familjes. Ngjashëm është gjendja edhe në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, në aspekt të përkufizimit të femicideve si vepër e posaçme penale, por ajo që ekziston në kuadër të legjislativit të këtyre vendeve është definimi i qartësuar i rrethanave vështirësuese (akti i vrasjes së gruas që bazohet në gjini; vrasja e partnerit; vdekja e gruas si pasojë e dhunës intime nga partneri).

Konventa e Stambollit gjithashtu i parasheh rrethanat vështirësuese për autorët e dhunës së bazuar në gjini, që duhet të merren parasysh si pjesë e Kodit Penal.

Përkufizimi preciz dhe i qartë i aspektit gjinor gjatë mbrojtjes penale juridike duke parashikuar dënime më të larta për autorët, që ka rëndësi të veçantë për parandalimin e femicideve si formë më e shpeshtë e vrasjeve të grave në shtetin tonë.

REKOMANDIME

Rrjeti Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave i realizoi të dy analizat e femicideve - vrasjeve të grave, edhe atë nga viti 2008 deri në 2016 dhe nga viti 2007 deri në vitin 2020. Këto informata, së bashku me përvojën e plotë të Rrjetit gjatë përkrahjes së grave viktime të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, janë themeli i rekomandimeve në drejtim të avancimit të sistemit për parandalimin dhe mbrojtjen e grave, viktime të dhunës së bazuar gjinore dhe dhunës në familje. Jemi të bindur se miratimi i rekomandimeve do të kontribuojë për parandalimin e femicideve si pasojë e një ekspozimi afatgjatë ndaj dhunës intime nga partneri ose dhunës në familje.

- 1. Ndryshime dhe plotësime të Kodit Penal duke e parashikuar femicidin si një vepër e veçantë penale,** ose plotësimin e rrethanave vështirësuese gjatë kualifikimit të vrasjes bazike me përkufizim më preciz të dhunës me bazë gjinore sipas shembujve nga vendet evropiane. Akti i vrasjes me bazë gjinore të gruas, vrasje e partnerit intim/bashkëshortes, vdekja e gruas si pasojë e dhunës intime të partnerit, feticidi femëror, vrasja e gruas ose vajzës në "emër të nderit" janë rrethanat e propozuara vështirësuese që nevojiten të jenë pjesë e Kodit Penal ekzistues.
- 2. Përkufizimi i propozuar i femicidit është "vrasja e grave me bazë gjinore"** që mund të paraqitet në më shumë forma: a) vrasje si rezultat i dhunës familjare/intime nga partneri; b) torturë dhe vrasje mizogjene e grave; v) vdekja e grave dhe vajzave si pasojë e praktikave të dëmshme (vrasja e grave në "emër të nderit", sakatimi gjenerital i femrave); g) vrasja e targetuar e femrave gjatë konfliktit të armatosur; d) vrasja e grave për shkak të priqës; gj) vrasja e grave për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor; e) infanticidi dhe feticidi femëror (përzgjedhja e bazuar në gjini); zh) lloje të tjera të femicideve në lidhje me bandat, krimin e organizuar, dogën, tregtinë me njerëz dhe posedimin e armëve.
- 3. Zhvillimi i një sistemi për mbledhjen e të dhënave** sipas gjinisë, përkatësisë etnike, vendbanimit (rural/urban), motivit të vrasjes, raportit ndërmjet viktimës dhe autorit, lidhja ndërmjet vrasjes dhe ekspozimit të mëherëshëm ndaj dhunës, historia kriminale e autorit, rrethanat në të cilat ka ndodhur vepra penale, në pajtim me udhëzimet e përcaktuara të Institutit Evropian për Barazi Gjinore, në mënyrë që edhe Republika e Maqedonisë së Veriut të jetë pjesë e statistikës evropiane të femicideve.
- 4. Krijimi i një Opservatori për përcjelljen e femicideve (Femicide Watch).** Qëllimi kryesor i opservatorit është krijimi i një sistemi për përcjelljen dhe njoftimin në kohë për vrasjet me bazë gjinore të grave, që përfshin edhe të dhënat për numrin e femicideve në nivel vjetor, të ndara sipas moshës së autorit dhe viktimës, raportit ndërmjet autorit dhe viktimës, si dhe informata për përndjekjen dhe dënimin e autorëve³⁰.
- 5. Ministria e Punëve të Brendshme në nivel të gjysëmvetorit dhe nivel vjetor të publikojë të dhëna për femicidet** - vrasjet e grave dhe vajzave.
- 6. Në pajtim me kriteret e parapërcaktuara, që janë harmonizuar me të dhënat e institucioneve tjera, Enti Shtetëror i Statistikës duhet të mbledhë të dhëna për vrasjet e grave dhe të publikojë raporte të posaçme në nivel vjetor.**
- 7. Në aspekt të parandalimit të femicideve të ardhshme, nevojitet që të avancohet procesi i marrjes së lejeve të armëve për qëllime private dhe zyrtare.** Në esencë, vlerësimi psikologjik i personit që ka parashtruar kërkesë dhe i është dhënë leja, patjetër duhet të përsëritet në intervale të përcaktuara paraprake. Vlerësimi i rregullt psikologjik nevojitet sepse gjendja psikike mund të ndryshojë si rezultat i ndodhive të përditshme (negative) në jetën e individit, dhe si pasojë mund të vijë deri te përdorimi i asaj arme të zjarrit për të lënduar ose privuar nga jeta ndonjë person tjetër.
- 8. Forcimi i kapaciteteve të nëpunësve policorë me uniformë, si dhe inspektorëve të dhunës në familje,** veçanërisht për të zbuluar format e ndryshme të dhunës dhe vlerësimin përkatës të rrezikut për jetën e viktimës, gjë që është e domosdoshme për të reaguar në kohë dhe për mbrojtje nga dhuna në të ardhmen që mund të rezultojë me femicid. Përfshirja e dhunës me bazë gjinore si temë në programin mësimor të trajnimit bazik për polic dhe si një modul u posaçëm në kurrikulën e rregullt të Akademisë Policore, është një zgjidhje më e qëndrueshme.
- 9. Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante, si dhe organizatat joqeveritare që punojnë në këtë çështje, duhet të realizojë fushatë të vazhdueshme për informimin e popullsisë në përgjithësi, në lidhje me rolin dhe përgjegjësinë e nëpunësve policorë** për mbrojtjen dhe parandalimin e formave të ndryshme të dhunës ndaj femrave.

30 Më tepër për Opservatorin e femicideve mund të gjendet në këtë [link](#)

BIBLIOGRAFIJA

1. Dr. Slobodanka Konstantinović Vilić, dr. Nevena Petrušić, Kosana Beker, Pancevo, 2019: DRUŠTVENI I INSTITUCIONALNI ODGOVOR NA FEMICID U SRBIJI I
2. Prof. dr Nevena Petrušić, Doc. dr Natalija Žunić, Dr Vida Vilić, Pancevo, 2019: DRUŠTVENI I INSTITUCIONALNI ODGOVOR NA FEMICID U SRBIJI II
3. Dr. Slobodanka Konstantinović Vilić, dr Nevena Petrušić, Pancevo I Nis, 2021: Pokusaj femicida I femicid u Srbiji: sprecavanje I procesuriranje
4. Shalva Weil, Consuelo Corradi, Marceline Naudi, 2018: Femicide across Europe: Theory, research and prevention
5. UNDP: Gender and SALW control: Legislative and policy frameworks in SEE
6. Academic Council on the United Nations System (ACUNS), 2017: Femicide Volume VII
7. UNODC, 2018: Global study on homicide: Gender related killings of women and girls
8. UNODC, 2019: Global study on homicide: Gender related killings of women and girls
9. SEESAC, 2019: Misuse of firearms in domestic violence in South East Europe
10. EIGE (European institute for gender equality), 2017: Terminology and indicators for data collection: Rape, femicide and intimate partner violence
11. Autonomous women's center, 2021: Analysis of cases of femicide committed with firearms (June 2017 – June 2020)
12. Women's AID, 2017: Behind closed doors
13. ХОПС, 2021: Dhuna e bazuar në gjini ndaj femrave që përdorin drogat
14. CEECAC, 2019: Gjinia dhe armët e vogla në Maqedoninë e Veriut
15. Rrjeti Nacional Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 2018: Analiza e rasteve të femicideve-vrasjeve të grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut
16. Autonomni ženski centar, 2021: FEMICID – UBISTVA ŽENA U SRBIJI Kvantitativno-narativni izveštaj (1. januar - 30. Jun 2021. Godine)
17. Rrjeti Nacional Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, 2018: Parandalimi, identifikimi, paraqitja dhe udhëzimi në rast të dhunës ndaj fëmijëve - Shqyrtimi i mekanizmave nacionale për përgjigje



Autori i publikimit

Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës në familje "Zëri kundër dhunës"

